

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-1
797



SATIRANTI



JUVENALI

34/6-1-

8H-1-2

797

JUVENALI

SATIRAT

(Pjesë të zgjedhura)

I përktheu: SPIRÓ ÇOMORA



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Titulli i origjinalit

Juvenalis, Decimus Junius: Satirae

Redaktor: ANDREA VARFI

Kopertina nga: SVIETLLANA STRAZIMIRI

Tirazhi 12.000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qëndrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1973

PARATHËNJE

Kur thotë Juvenali se romakët e kohës së tij kishin nevojë vetëm për «padronë, bukë dhe festa» («Satira X», v. 73 në origjinal), këto fjalë nuk duhet të merren si një përbuzje për bashkëqytetarët, por si një pohim burrëror lidhur me realitetin e hidhur të kohës. Duke e çuar gjër në caqet më të fundit politikën klasore të oligarkisë republikane patriciane, që synonte t'i katandiste plebejtë në masa të thjeshta pa të drejta e pa liri, pushteti perandorak as nuk u dha «dinjitetin e dikurshëm tribunëve të plebejve» të dëbuar nga kryeqyteti, as nuk «çliroi popullin nga zgjedha e një grushti uzurpatorësh», siç premtonte Cezari (përpara vitit 49 para erës sonë), kur bëhet sundimtar i plotfuqishëm. («De Bello Civile», I. 22,5). Përkundër, kjo zgjedhë nën pushtetin perandorak u bë edhe më e rëndë, më mbytëse. Shumë shpejt u zhduk çfarëdo lirie qytetare. Diktatorët ushtarakë jo vetëm kishin asgjësuar po edhe vazhdonin të asgjësonin kundërshtarët republikanë më të vendosur me çfarëdo mjeti.

Ata, me anë shpifjesh, mbi të cilat fabrikonin akuza të rreme dhe gjyqe, vazhdonin të zhduknin gjithë njerëzit e ndershëm, «kundërshtarë të mundshëm të tyre në të ardhmen». Ata vrisnin natën e qanin ditën figura të shquara kulture e arti. Përhapnin me të dy duart korrupcionin dhe prostitucionin me anë të parasë së shumtë, të grumbulluar, me spekulime dhe taksa, duke u nxjerrë shpirtin popujve të shtypur. Sthurja po bëhej epidemi, që përfshinte në dallgët e veta edhe gratë e sundimtarëve, aty dhe perandorëshat, si famëzeshën Mesalinë, të shoqen e perandorit Klaudi I. Edhe gruaja e dytë, Agripina, që mori Klaudi I, pasi vrau Mesalinën, nuk i doli më e mirë. Kjo e helmoi Klaudin I pasi i mori këtë perandori pëlqimin që të adoptonte si bir, e pra, edhe si trashëgimtar të fronit perandorak, birin e saj me burrin e dytë, famëkeqin Neron. Dhe ky Neron, si shkëmbim për mirësinë që i bëri, e vrau të ëmën, Agripinën, sapo u bë perandor në vitin 59 të erës sonë, atëhere kur Decim Jun Juvenali, ky bir fshatari ernikas, i lindur në një qytet të vogël të Laciomit, në Akuin, sapo kishte mbushur të katër vjetët (po të pranohen si të sakta datat e përafërta: për lindje: viti 55, për vdekje viti 130).

Pushteti perandorak, në luftën e tij sistematike për të zhdukur jo vetëm rezistencën dhe kujtimin e lirive të dikurshme, po edhe çdo mundësi zhvillimi ekonomik të plebejve, krahas korrupcionit dhe pros-

titucionit kishte lehtësuar dhe po lehtësonte shumë edhe grumbullimin në Romë të spekullatorëve, të fajdexhinjve, të sipërmarrësve më pa skrupull që mund të gjendeshin në gjithë perandorinë. Duke u mbështetur në këtë «borgjezi» afaristësh pa atdhe, që i truhej vetëm «Zotit Kacidhe», siç thotë Juvenali (Satira» I), dhe, në mënyrë të veçantë, në një ushtri dhe në kuadro ushtarake mercenare, të cilëve përherë e më shumë u shtonte privilegjet, ky pushtet cezarësh mbante nën sundim masa e popuj dhe Romës i jepte përherë e më tepër tiparet e një metropoli kozmopolit. Por kjo fuqi përherë e më e madhe e ushtarakëve dhe e ushtrisë, e nisur prej vetë Cezarit kur kaloi Rubikonin dhe kur u fut në Romë për të zhdukur kundërshtarët, shumë shpejt krijoi rrezikun e «puçeve ushtarake» në Perandorinë skllavopronare romake. Dhe ngjarjet e mëvonshme e provuan këtë më së miri. Nga ish-ushtarakët me prejardhje të huaj, që përherë e më me shumicë (kryesisht për shkak të privilegjeve të shumta që gëzonin si ushtarakë) mbushnin radhët e legjioneve romake, me dyzina qenë ata që, me anë puçesh ushtarake, nisën të merrnin frenat e perandorisë në duart e tyre.

Shoqëria skllavopronare romake, e brejtur së brendshmi e së jashtmi nga kontradikta të forta antagonistë, Roma kozmopolite e korrumpuar, edhe pse më vonë përqafoi «ideologjinë e skllavëve», kristianizmin, për ta përdorur po kundër skllavëve, nuk

kishte si t'u bënte ballë shpërthimeve të brendshme klasore, revoltave të fiseve të shtypura, si dhe vërshimeve të jashtme të popujve barbarë.

Karakteri kozmopolit, korrupcioni dhe prostitucioni vazhduan në Romë edhe kur skeptrin e cezarëve si «Pontifeksë të epërm» e muarën papët e kohës feudale. Ky korrupcion e prostitucion vazhdoi të luftohej edhe shumë kohë më vonë prej Dantes e Petrarkës me shokë, ashtu siç u luftua prej Juvenalit, tek poezia e të cilit po kthehem, pas kësaj pasqyre të shpejtë të ambientit dhe të shoqërisë romake para, gjatë dhe pas Juvenalit.

Juvenali «Satirat» e tij i shkroi në moshë mjaft të pjekur, pasi e kishte njohur mirë shoqërinë romake si njeri i elokuencës dhe i drejtësisë, i shkroi i shtyrë nga pezmi i fortë që i ziente brenda kraharorit, kur shikonte se me dyzina poetucë, në vend që të pasqyronin realitetin e kohës dhe të goditnin krimet, poshtërsitë dhe fëlliqësitë, arratiseshin në subjekte të stërsHFrytëzuara të mitologjisë greke, të trajtuara në mënyrat më anemike dhe me një frymë kozmopolite. Rruga që zgjodhi, shpata që rrëmbeu për ta vringëllitur kundër të plotpushtetshmeve të kohës, ishte shumë e rrezikshme për vetë kokën e tij. Po Juvenali, i ndërgjegjshëm për detyrën e tij fisnike, u hodh në sulm. Si njeri i drejtësisë, për t'i shpëtuar juridikisht përgjegjësisë penale po të godiste të plotpushtetshmit e gjallë, goditi të plotpushtetshmit që sapo

kishin pushuar së jetuari. Duke qenë se në shoqërinë romake asgjë nuk kishte ndryshuar, vazhdonin të bëheshin të njëjtat krime e poshtërsi, «Satirat» e Juvenalit ktheheshin në një aktakuzë publike kundër vetë shoqërisë ku ai jetonte.

Veprat e tij «Satira» përfshin 16 poemthe. Prej tyre, në shqip jepen vetëm «pjesë të zgjedhura» nga 7 prej poemthave. Sigurisht që janë pak, por të mjafta për një takim të parë të lexuesve tanë me krijmtarinë poetike realiste të këtij poeti të madh kombëtar të popullit romak.

Duke lënë mënjanë Satirat I, 3, 4, 7, 8, 10, 14, rreth të cilave lexuesit mund të formojnë një ide edhe prej pjesëve të zgjedhura të tyre që botohen në shqip në këtë vëllim, po ndalemi fare shkurt në kryeidetë e Satirave të tjera të Juvenalit. Në Satirën 2 sulmon hipokrizinë dhe sjelljet e turpshme të burrave që s'janë burra. Në Satirën 5 paraqet poshtëritë e disa zotërinjve dhe nënshtrimin e pështirë të parazitëve dhe rixhaxhinjve të tyre. Në Satirën 6 godet gratë aristokrate të korrumpuara, të gatshme për çdo poshtërsi dhe përvërsitet seksual. Në Satirën 9 godet pushtët dhe ashikët idiotë, viktimat të pushtëve. Në Satirën 11 godet drekat e darkat plot falsitet dhe shpenzime të tepërta të pasanikëve dhe lëvdon drekat e darkat e thjeshta e të përzemërta të plebejve. Në Satirën 12 paraqet batakçinjtë, që nuk lenë gur pa lëvizur për t'u bërë trashëgimtarë pasurish të të

tjerëve. Në Satirën 13 vë në epiqendër ndërgjegjen, e cila, për çdo poshtërsi, duhet të jetë ndëshkuesja më e fortë e njeriut. Në Satirën 15 godet fanatizmin fetar dhe egërsinë që manifestohet në shoqërinë njerëzore. Në Satirën 16, e cila i ka mbetur e pambarruar, godet, siç kemi thënë edhe më lart, privilegjet që shoqëria romake u kishte krijuar ushtarakëve dhe ushtarëve.

Juvenali, «i vetmi poet i vërtetë shoqëror i lashtësisë romake», nëpërmjet Satirave të tij jo vetëm na jep një tablo të gjerë dhe të thellë të realitetit të kohës, po ai godet drejtpërdrejt vetë Perandorinë, shfrytëzimin e vendeve të pushtuara, etjen e shfrenuar për t'u veshur me pushtet dhe për t'u pasuruar, duke shtuar kështu korrupcionin dhe prostitucionin, padrejtësitë, krimet, duke çromanizuar dhe kozmopolitizuar Romën dhe romakët. Është e vërtetë se Juvenali nuk e ka e nuk mund ta kishte të qartë perspektivën, pra, nuk shikon ndaj së ardhmes. Po, edhe duke lavdëruar thjeshtësinë, burrërinë, çiltërinë, besnikërinë, kultin e dashurisë për punën dhe për vendlindjen që kishin romakët e lashtë dhe që vazhdonin të qëndronin të gjalla te plebejtë, te malësorët dhe fshatarët e lirë, Juvenali e vë shumë mirë gishtin në plagët e kohës. Në vend të një perandorie kozmopolite, ai kërkon një shtet të vogël latin, të latinëve dhe për latinët. Pra, vendet e tjera, të banuara prej popujsh të tjerë, nuk duhet të bëjnë

pjesë në këtë shtet. Roma kozmopolite duhet të kthehet në një Romë të romakëve dhe për romakët.

Juvenali, edhe pse jeton në shoqërinë skllavopronare, njihet vetëm një fisnikëri, fisnikërinë shpirtërore, të cilën çdo njeri, pavarësisht nga prejardhja, duhet ta mbrojë, ta gatujë dhe ta pjekë po me duart e tij. Te plebejtë shikon forcën e përtëritjes romake; prej gjirit të tyre kanë dalë dhe dalin njerëzit e të gjitha dijeve dhe arteve.

Edhe pse nuk përfshin në programin e tij një përtëritje shoqërore të thellë antiskllavopronare, Juvenali është gati ta shqyejë padronin që i përgjak me kamzhik kurrizin skllavit. Për Juvenalin, «shpirti dhe trupi i skllavit vlejnë sa edhe ata të njeriut të lirë» (Satira XIV, v. 15-18). Për sklleverit ai ndjen mëshirë e dashuri. Fshikujt Juvenali i ka për të tjerët (Satira XI, v.145). Në emër të natyrës, e cila kërkon që të gjithë njerëzit të jenë të mirë, Juvenali, në «Satirat» e tij, na le këtë porosi — testament: të luftojmë që «një dashuri reciproke të bashkojë njerëzit e shpërndarë në një popull të vetëm, të vëllazëruar brenda mureve të të njëjtit qytet!» (Satira XV, v. 164-168).

Juvenali është i madh edhe si artist. Gjuha e tij nuk noton në figura dhe krahasime artificiale, pas të cilave zakonisht bien në ekstazë kritikët diletantë. Efektin më të madh artistik Juvenali e arrin me mjeshtrinë e rrallë që tregon në përdorimin e goditur

të emrit dhe të foljes. Tek folja ai përqëndron fuqinë koloristike të shumë mbiemrave të marrë së bashku. Arti i Juvenalit është frut i vëzhgimeve të drejtpërdrejta të jetës dhe të fenomeneve.

Ironia e Juvenalit përmban «zymtësinë e ftohtë të sarkazmit, zhuritjen e papritur të epigramit, qesëndinë e vrazhdë të përqeshjes komike». Satira e Juvenalit nuk ka elegancën thuasjse obortare të asaj të Horacit. Kjo është satirë e shëndoshë fshatare, satirë e një njeriu të pastër, që i sheh poshtërsitë me përbuzje dhe revoltohet ndaj tyre, pa u zhytur në to.

«Satirat» e Juvenalit, edhe pse reaksioni skllavopronar për dyqind vjet bëri çmos për t'i varrosur nën pluhura bibliotekash, këto që prej shekullit IV të erës sonë shpërthyen arkat e pluhurosura të bibliotekave dhe përsëri u rreshtuan në radhët e para të luftëtarëve kundër çdo fëlliqësie të shoqërisë njerëzore. Shumë herët këto u bënë populllore, jo vetëm në Itali, po edhe në pjesët e tjera të Evropës, sidomos në Francë dhe në Gjermani. Sot janë të njohura në gjithë botën. Jemi të sigurt se edhe në vendin tonë për vlerat e tyre të larta ideoartistike, ato do të mirëpritën. Duhet theksuar edhe merita e përkthyesit, poetit Spiro Çomora, i cili këto vlera ka arritur të na i japë me besnikëri dhe në një gjuhë poetike të pastër dhe të kapshme nga të gjithë.

Andrea Varfi

LIBRI I PARË

Satira I

Përherë u dashka që unë të mbyll gojën
dhe vetëm të dëgjoj? Mos nuk erdh koha
t'u tregoj vendin fyçkave si Kordit
të ngjirur, që më ka shurdhuar veshët
kaqë herë me «Teseidën» e tij? 5
Po patët kohë e ëndje, më dëgjoni
përse vendosa që të zbres në fushën,
ku ngau i biri i madh i Aurunkës
kuajt me vrap... Kur je i shtrënguar
të shohësh se si gjithë patricianëve 10
ua kaloi në kamje edhe njëri,
që, kur kam qenë djalë, më pat rrojtur
mjekrën me brisk si me hanxhar të ndryshkur;...
kur je ti i shtrënguar të shikosh
rreth e qark teje plot fëlliqësira, 15
vallë a përmbahesh dot pa mos e rrokur
armën satirë? Po ku vallë u gjendka
aqë durim, sa të durosh vendlindjen
të shturet fund e krye? Po kush vallë

është aqë zemërgur dhe përmban veten, kur përmbi lestë, i mbartur prej skllevësh,	20
sheh të ngrehosur si buall i ndyrë, një avokat Maton, apo kur sheh pas tija, duke ardhur, pikërisht një prej atyre që, si fik me shpifje një mik të shquar, gati na mban kthetrat	25
të gllabërojë gjithë ç'kanë mbetur nga patricianët, rënë sot fort ngushtë?... Mund të përmbaj mërinë që ndjej unë, kur shoh se si grabitësi i një foshnje, shpejt të përflakur rrugës si lypësare,	30
njerëzinë e shtyp me frotën e sejmenëve? Apo kur shoh se si Marius kusarit, dhe pas dënimit dhe emrit të keq, paret s'i ngiten dhe sot me to dehet e bën ç't'i teket në vend — internimin?	35
Gjithë këto fëlliqësira vallë s'mund t'i cilësoj si fare të përshtatshme të pendës së Fenerit të Venozës? A kam se si të mos ua nënshtroj shigjetave të mia satirike?	40
Kur ke përpara gjithë këto plagë, s'mund të vazhdojnë të më frymëzojnë të bëmet e Diomedit dhe Herkuli, fëmija që u mbyt, apo Ikari, gjersa ka bashkëshortë në mes tonë,	46
lajmës të bashkëshortëve të tyre,	

që ua pranojnë edhe pasuritë
 të lena nga të dashurit e grave
 në testament, se gratë s'trashëgojnë;
 burra që dinë t'i drejtojnë sytë 50
 lart, në qiellzanë, e rrinë e gërhasin,
 sipas nevojës, duke qenë zgjuar,
 me hundën të pështetur buzë kupës;
 gjersa ka njerëz nga ata, që e quajnë
 të drejtë t'ëndërrojnë komandime 55
 kohortash, pasi lanë gjithë ç'kishin
 në vende kurvërie e në stalla
 dhe bënë tym të gjithë pasurinë
 që u lanë pas stërgjyshërit e tyre...
 Nuk është pun'e këndëshme të shkruash 60
 satira edhe mb'udhë, kur shikon
 një falsifikator (që u pasurua,
 se di të vërë vulën e të zgrapsë)
 përmbi një lestë t'hapur, që e mbajnë
 mbi supe shtatë sklevër dhe vjen rrotull 65
 posi një Mecenat me bark përpjetë?
 Ja ku po vjen një zonjë derë rodi
 të madh, që i jep burrit të stëretur
 verë Kalene t'ëmbël, të trazuar
 me helm brektose! Kjo është një zonjë 70
 shumë më e përsosur se Lokusta,
 që u mësonte të bijave të ndershme
 mënyrën si t'i nisin n'atë jetë
 burrat që s'i pëlqejnë më! E, sa për

namin e mirë e çfarë thotë populli, ajo s'pyet!... Lëvdohet ndershmëria, por të çon në varr; kurse çdo krim që bëhet, shpërblehet me bulqiza, me gostira, nderime pretoriane, me takëme	75
ergjëndi nga të moçmet dhe me kupa që kanë si stoli fytyra cjepësh e mbahen më dy këmbë... Sado që poet nuk linda, mua pezmatimi m'i dikton vargjet të tilla, edhe vetë i hedh në letër e mundohem t'i thur	80
ashtu si mund t'i thur unë e Kluvieni... Ndrojtjet, pasionet, qejfe e gabime po grumbulloj në librin tim të vogël. Kaq shumë rasa kurrë s'kemi pasur... Këtu tek ne tani gjëja m'e shenjtë	85
qenkërka Madhëria e saj Kuleta, sado që ti, Zot ugursëz Kacidhe, s'e ke akoma vendin në një tempull; sado që gjer më sot s'u kemi ngritur Monedhave altar, ashtu si ka	90
altarë për Besimin e për Paqen, altarë për Fitoren e Virtutin!.. Me kaq maisje vesesh që sot kemi, besoj se kurrë nuk ka për të mundur e ardhmja të na shtojë më të liga.	95
Pasardhësit ne mjeshtra do na kenë në këto turpe, nëse do na ndjekin	100


e s' do t' u vijë ndot nga turpet tona.
Çdo ves, kur arrin kulmin, s' ka ku zbret
më poshtë... Dikush ndoshta mund të thotë: 105
«Ku do t' i gjesh të gjitha aftësitë
për të përshkruar kaqë e kaqë vese?
Ku do ta gjesh gjith' atë çiltëri
të lashtë, që të duhet për të shkruar,
gjith' atë çiltëri të thjeshtë, 110
që sot s' guxoj as emrin t' ja përmend?»
«S' ngre peshë nëse Muçi i miraton
o nuk i miraton fjalët që shkruaj.»
«Rreziku qëndron gjatë. Fyej pak,
për shembull, Tigelinin! Do të shkosh 115
për t' u gozhduar si pishtar në shtyllat,
ku digjen njerëzit duke nxjerrë tym
nga gjoksi i tyre i shpuar!»... «Po ahëre,
them unë, ky fisnik, që ka helmuar
tre ungj të tij, do të vazhdojë akoma 120
shetitjet sipër lestës plot me pupla
e të na shohë q' andej lart si pleshta?»
«O, mik i dashur, po të të rastisë
ta takosh mb' udhë, mbylle gojën mirë;
mjafton të thuash vetëm «ja tek është», 125
që të dyshohesh si njeri fajtor...
Andaj, përpara se t' u bjesh borive,
i mendo mirë fjalët që të thashë
për sulmin që ke nisur kundër tyre.»
«S' ka gjë, ju gjegja, do shoh ç' na lejohet 130

dhe kundër atyre që hiri, pasi vdiqën,
u ruhet që së lashtit nëpër boskat,
gjatë udhëve Flaminia e Latina...»

SATIRA III

Sado që u habita kur u nis
një mik i vjetër, unë e përgëzoj
që na vendos' të shkojë të banojë
në Kuma, ku s'ka më frymë njeriu,
edhe kështu Sibilës t'i dhurojë 5
një qytetar të ri. Kuma është skelë
e Bajës, një bregdet shumë tërheqës,
një vend zbavitje e prehjeje. A mendoni
se unë sot, në vendin e Suburrës,
do pëlqeja qoftë edhe Procidën? 10
Me të vërtetë, nga sa kemi parë,
në ç'vend të mjerë, ku, në ç'shkretëtirë
do të banonim më keq se në Romë,
ku kërcënohesh vazhdimisht nga zjarret,
nga shembjet e shtëpive, nga njëmijë 15
rreziqet e ksaj Rome t'egër, ku
të ndjekin recitime poetucësh
edhe në gusht? Ndërsa, pra, ja ngarkojnë
takëmet në një karro, një «prit pak!»

dhe ndalet shpejt me mua miku im... 20
Dhe kështu nisi Umbrici të më thotë:
«Gjersa këtu, në Romë, nuk i ka
njeriu mundësitë të punojë
me nder, sepse ç'do pune të nderuar
s'i jepet më tani asnjë shpërblim; 25
përgjersa gjendja e sotme ekonomike
është m'e keqe se ajo e djeshmja
dhe nesër do të jetë ca m'e keqe
se kjo që kemi (e s'ka ku shkon më tutje),
unë vendosa që të shkoj në Kumë!... 30
Tani që nisën të më thinjen flokët,
tani që jam në prak të pleqërisë
edhe mezi mbaj trupin drejt kur ecij,
po le atdheun tim sot, të përshtatshëm
për të vepruar Artori e Katuli, 35
që e kthejnë ç'është e bardhë, në të zezë;
që marrin lehtësisht në sipërmarrje
shtëpi, skela, lumenj, tharje gjirizash;
që djezin dhe kufomat e të vdekurve;
këta nëpër ankante nxisin sklevër 40
për hiç të shesin kokën ndër padronë!
Dikur, këta të gjithë s'kanë qenë
veçse britarë, që endeshin përherë
nër cirkuse krahinash, disa fyçka,
që mezi hanin bukë nëpër fshatra. 45
Por sot shpërndajnë çmimet nëpër ndeshjet
dhe, që t'i hyjnë popullit në zemër,



28416

17

me gishtin e madh nxisin që të vritet
ai prej gladiatorëve, që ata
duan ta shohin shtrirë! E pastaj, 50
pasi të dalin jashtë amfiteatrit,
marrin, në sipërmarrje nevojto
qyteti! E pse jo? Mos vallë s'janë
të zotë për çdo gjë? Nuk ka dyshim!
Çdo herë që ka qejf fati të lozë, 55
merr një nga këta tipa dhe e ngre
në postet më të larta e plot shkëlqime!
Po unë ç'mund të bëj në Romë? Unë
s'di të gënjej... Pa paraqit, të lutem,
një dëshmitar të ndershëm në gjykatat 60
e Romës. Ç'e pyesin? Për të ardhurat,
edhe në fund për ndershmërinë e tij:
«Sa sklevër dhe pendë qe ti ke?
Me ç'lloj takëme buke mund të mburresh
nëpër gostira edhe sa kushtojnë?» 65
Ç'e do! Vlera morale dhe besimi
që ti mund të gëzosh, varen nga paret
e kyçura që mban nëpër sëndyqe!
Bëj bera e rrufera sa të duash,
makar për perënditë e Samotrakës, 70
edhe për perënditë tona bashkë;
s'ka burrë që u shkul bindjen se i varfri
s'pyet për perëndira e për rrufera —
dhe kjo për shkak se vetë perënditë
i falin shpesh mëkatet e atyre. 75

E ç'të tregosh për talljet që i drejtojnë të gjithë varfanjakut, po e pati zhgunin e tij të ndotur e të grisur, togën të ndotur, sandalen të shpuar?...	80
Vojtja m'e pamëshire që ka sjell pas vetes varfëria, është se e bën atë që vuan qesharak!	
Dëgjo zërin që çirret: «Jashtë! Jashtë! Kush nuk ka mjaft të holla, le të çohet! Larg vendeve plot luks, ku vijnë vetëm kalorësit!» Po pate turp, dil jashtë!	85
Këtu le të qëndrojnë gjithë ata fëmijë të rrufjanëve, në çfarëdo bordelli qofshin lindur! Dhe kjo ndodh, sepse kështu ja dashka qejfi Otonit, q'e ndau popullin në gjith'ato klasa, të shquara fort mirë midis tyre...	90
Ç'është e vërteta, pjesa më e madhe e njerëzve në Itali nuk veshin më togë, veç kur ndodh të mbyllin sytë...	95
Shumica e të sëmurëve në Romë vdes nga pagjumësia e tepruar... Cila banesë i ka kushtet që duhen që ti të mund të flesh? Këtu, në Romë, vetëm ata zotërinj, që zotërojnë thesarë mund të flenë... Pasaniku, kur del për ndonjë punë nga shtëpia, i hipur mbi një lestë, që e mbajnë	100

mbi sup disa liburnë trupmëdhenj,
 çan udhën përmes turmës. Aty brenda 105
 shkruan, lexon e rrallë e tek dhe fle;
 se lesta, kur i ka perdet të ulura,
 sjell gjumin mbi qepalla... Ja ku vjen
 një qerre e ngarkuar me një trung
 të gjatë pishe. Barra dallgëzohet 110
 në qerre lart dhe rrezikon të bjerë
 përsipër turmës. E, po u përmbys
 një prej atyre qerreve që mbarin
 shkëmbinj Ligurje edhe po rrëzoi
 mbi turmën njerëzore një mal gurësh, 115
 ç'mbetet nga kaqë trupa njerëzorë?
 Ku mund t'ua gjesh copat edhe koskat?
 Fati i njeriut të varfër çenka ky;
 të japë frymën bërë copë e thrime,
 ashtu siç është bërë copë e thrime 120
 dhe shpirti i tij!... Ja ku të del përpara
 një pijanec! Të urdhëron të ndalesh,
 thërret: «O hape gojën, o ta ngopa!»
 N'daç flet, n'daç matesh t'ikësh duke heshtur,
 është njësoj: të shkund me disa shkelme 125
 edhe pastaj, në kulmin e zemrimit,
 të hedhin si fajtor në gjyq! Ja ç'është
 liria për të varfërit: të lutesh,
 kur ti ha dru, i nxirë nga të rrahurat,
 edhe t'i biesh tjetrit ti më gjunjë, 130
 në pastë zemër që të të lejojë

të shohësh shtëpinë me ndonjë dhëmballë
 akoma të pathyer... Ku, në ç'furrë
 a kudhër Rome sot nuk na kaliten
 vargonj të rëndë? Hekuri që kthehet 135
 për pranga, është aq i shumtë, sa
 kam frikë mos një ditë s'do të kemi
 as për parmenda dhe lopata e cfurqe.
 Si lum ata stërgjyshër kasstërgjyshrish
 tanë; e lume koha e perënduar, 140
 kur Roma e ndjente veten të kënaqur,
 me një burg vetëm, — dhe ai mjaftonte...

Satira IV

Kur Perandori i fundmë, derë e Flavëve,
 shqyente botën që po jepte shpirt,
 dhe Roma ju përul atij, posi një skllave,
 tullac Neronit, në detin Adriatik
 një peshk i madh u ndal përpara tempullit 5
 të Afërditës, q'është në Ankonën
 dorike. Trupi i madh i atij peshku
 e mbushi fund e krye gjithë rrjetën...
 Ahere, i zoti i lundrës e i rrjetës
 vendosi që atë peshk të madh t'ja falë 10

mësallës së Pontifeksit të Epërm.
 Ç'është' e vërteta, kush do kish guximin
 ta shiste o ta blente atë lloj peshku,
 kur gjithë bregu i detit ishte mbushur
 plot me spiunë? Rojet e bregdetit, 15
 që ishin të pranishëm në çdo anë,
 do ta kishin sulmuar menjëherë
 të ngratin barkatar e s'do ngurronin
 të thoshin se «ky peshk ishte ushqyer
 një kohë mjaft të gjatë në dajlanet 20
 e Perandorit; pra, gjersa na iku
 q'andej, duhet të kthehet me çdo mjet
 pranë atij padroni që kish pasur!...»
 Të gjithë senatorët, që s'u thirrën
 akoma n'audiencë, po shikojnë 25
 peshkun që hyn në pritjen imperiale.
 Sapo arriti ballë Perandorit,
 Picetin peshkatari, tha kështu:
 «Pranoje këtë peshk, që është shumë
 i madh për një fëltere qytetari 30
 t'ulët! Kjo ditë e sotme e shënuar
 qoftë një ditë feste! Shpejto, pra,
 ta zgjerosh fort stomakun tënd dhe haje
 këtë lloj peshku, që ja ruajti fati
 Madhëris' sate! Ky peshk deshi vetë 35
 të kapet!» Vallë kush do mund të tallej
 më hapët se kështu? Megjithatë,
 kreshtën e vet e ngriti Perandori

- edhe më lart. Se fylat si ai,
n'ushtrimin e funksioneve të tyre, 40
kur mburren nga të tjerët e nderohen
si perëndi, ahëre ata trutharë
dhe lajkën më pa kripë e besojnë.
Dhe, pasi s'gjendkej dot gjëkund fëltere
për gjithë atë peshk, shpejt Perandori 45
Thrret në këshillë ahëre senatorët,
të cilëve s'kish qejf t'u shihte as bojën.
Këtë dhe pleqtë e dinin; andaj dhe
gehret e tyre, me zbehtësinë e thellë,
provonin si i kishte katandisur 50
miqsia e sovranit august.
Sa tha gardian Liburni «Shpejt! Vraponi,
se Perandori zuri vend në fron!»
i pari që e mblodhi shpejt-shpejt togën
dhe rendi, ish Pagasi; ai rezil, 55
që, për çudinë e Romës, na caktohet
dhe si i parë për gjithë qytetin...

LIBRI I DYTË

Satira VII

Shpresa për lulëzimin e studimeve
dhe se si mund t'i bësh të lulëzojnë
më mirë ato, këto janë dy gjëra
që i ka në dorë vetëm Perandori.
Vetëm ai, në kohën që jetojmë, 5
mund t'u drejtojë muzave vëmendjen,
ndërsa shumë poetë të dëgjuar
po vrasin mendjen si të mbarështojnë
në Gabio ndonjë farë ngrehinëzë
verore banjash deti, si të hapin 10
në Romë ndonjë furrë, a të bëhen
kasnecët e shitblerjeve të tregut.
Klioja e shkretë është aqë e uritur,
saqë u detyrua të braktisë
luginat e burimit Aganip 15
për të trokitur dyersh pasanikësh.
Po qe se ndënë hijen Pieriane
nuk gjen makar as një hije Kacidhje,
s'do mend se ti më mirë do pranosh

emrin edhe jetesën e çdo Mâskere 20
e do fillosh të shesësh çeturina
tok me poemat «Tére» e «Tebaidë»
të Faustinit dhe «Alçito» të Paçit
do nxjerrsh n'ankand mishmash voza të vogla,
trekëmbësh dhe dollapë me kanistra. 25
Më mirë është kështu, sesa të shkosh
në gjyq e të dëshmosh para gjyqtarit
se paske parë atë që, ç'është e drejta,
ti s'e pe kurrë. Jo, një turp të tillë,
të falsifikatorit të dëshmive, 30
le ta ushtrojnë gjithë rrezikzeztë
e Bitinis', Kapadokisë, Azisë;
le ta ushtrojnë ata që na përcjell
në Romë, këmbëzbathur, Galacia.
Megjithatë, që sot e tutje, asnjë 35
letrar n'ata që na plazmojnë gjuhën
e tyre poetike me harmonira
të ndryshme muzikore dhe që patën
kurora lari të ndershme mbi krye,
s'do jetë i detyruar të pranojë 40
një punë jo të denjë për studimet
e tij. Mendohuni mirë, o të rinj!
Sot Perandori ju shikon, ju çmon dhe
me zemërgjerësinë e tij auguste
kërkon t'i jepni shkak që ai të mundë 45
ta shfaqë zemërgjerësinë e tij.
Në, Telesin, kujton se u dashka pritur

nga burim tjetër ndihma e domosdoshme dhe, i gënjyer nga një shpresë e tillë, ti bën vepra letrare e mbush vëllime,	50
e ahere rend, më mirë, o ti poet i varfër, dhe gjej një dorë shkarpa për të djegur krijimet që ke shkruar ti për nder të burrit t' Afërditës, ose futi veprat e tua thellë në sëndyq	55
t'i brejë mola; thyeje, o i mjerë, pendën, shkatërro frutet e përpjekjeve të tua kaq të gjata ti, që shkruan në një odiçkë vargje të shkëlqyer, që të fitosh kurorë shermasheku	60
e një shtatujë varfanjake! S'ke më shpresë tjetër, se tani të pasurit kopracë kanë msuar t'admirojnë e të lëvdojnë njerëzit shkollarë vetëm me brohoritjet që fëmijët e vegjël admirojnë atë zogun e shenjtë për Zeusin. Por, ndërkaq, kalon dhe mosha që të jep fuqinë të përballesh dete e shata e përkrenare. Ahëre neveria të hyn në shpirt	70
dhe pleqëria e zhveshur, grindavece, urren dhe veten tok me Terpsikoren. Dëgjo tani se ç'djallëzi përdor ai zotri, që ti po përkëdhel me shpresë mos të jep ndonjë kacidhe.	75

Ti, që ta mallëngjesh, ke lenë tempullin
 e muzave e t'Apolonit, por
 — plastë syri i lig! — dhe ai bën vargje
 dhe është më i vogël se Homeri
 vetëm se ky i fundit mban lavdinë, 80
 që lindur ka njëmijë vjet përpara!
 Sikur, e zëmë, ti, i gudulisur
 nga nami, të kesh qejf për recitime
 publike, ai të jep — por hua — një
 banesë të fëlliqur dhe urdhron 85
 të të lirohet një shtëpi, e mbyllur
 me hekura prej kohe, që e ka hyrjen
 tëpkë posi dyert ndër ato kështjellat,
 rrethuar nga çdo anë. Dhe
 të jep dhe ca ish-sklevër që të shkojnë 90
 aty nga fundi i sallës e të zënë
 fronet e vendeve të fundit, ose
 bën gati brohoritjet e ca krushqve
 që thrrasin fort... Por asnjë prej atyre
 zotrinjve të mëdhenj s'do të të japë 95
 gjësend për të paguar ti biletën
 e froneve dhe llozhave të ngritura
 në trarë, o biletën e platesë
 me frone luks, që ti, si çdo gjë tjetër,
 më vonë do t'ja kthesh sërish padronit. 100
 Megjithatë, ne bëjmë therorira:
 po hapim brazda në rërë të hollë,
 bregun e detit ne po e lërojmë

- me një parmendë shterpë. Po kërkove
dorë të heqsh nga jeta, ti gozhdohesh 105
aty në vend nga ethet e ambicies,
që ta shtrëngon në fyt gjithë litarin,
Mania e shkrimit është një sëmundje
që nuk shërohet dot dhe që shkakton
kurdo viktima dhe bëhet kronike 110
në çfardo zemër të prekur prej saj.
Mirëpo një poet, që rri më lart
nga vendi ku na rri frotë e rëndomtë,
një poet që nuk të shkruan kurrë
për asnjë gjë që mund të jetë e njohur, 115
apo dhe e përbuzur nga të tjerët,
që nuk përpiqet të na ngjizë këngë
për hir t'asaj kacidhje të pacipë,
them, ky poet, me plot merita shpirti,
do të na bëhet një Poet plot gojën, 120
vërtet Poet, kur ky do të shpëtojë
nga halle dite dhe do fshikullojë
për pastërti natyre e i përlindur
q'etjen e tij ta shuajë ndër burime
kristali muzash aonide. E pamundur!
Poeti s'këndon dot kur është i mbyllur, 125
s'ka dehje frymëzimi kur jeton
në varfëri, kur s'ka asnjë kacidhe,
kur duhet të përpiqet ditë e natë
të qetësojë zorrët nga uria.
Kur thurret «shëndet!» Horaci, e ka plot barkun! 130

Kur mund t'i japë zemra mundësinë
 gjenialitetit që të fluturojë?
 Vetëm kur zemra është e shqetësuar
 vetëm nga frymëzimi poetik
 edhe u nënshtrohet vetëm ligjeve 135
 të Cirrës e të Nisës. Po s'jetohet
 vetëm me zemër; që të përfytyrosh
 qerret, kuajt, fytyrën e hyjnive
 e të Irinës, që errësoi gjykimin
 e Rutul Turnit, duhet mendje e madhe, 140
 që s'katandiset në hallin qesharak
 t'atij që s'mund të blejë dot një perde.
 Sikur Virgjilit t'i kishin munguar
 i vetmi shërbenjës që kish pasur
 edhe ajo shtëpi ku fuste kokën, 145
 do kishin rënë gjithë gjarpërinjtë
 prej flokëve të fùrive të tija,
 buria e tij do t'ishte bërë e shurdhër,
 asnjë tingull epik s'do kishte nxjerrë.
 Kush paska para na qenka gjithmonë 150
 i bukur edhe trim! Kush paska para
 na qenka gjithëmonë një njeri
 i ditur, trim e i fismë brez pas brezi,
 që ka fytyrë e hënë në sandale!
 Kush paska para na qenka gjithmonë 155
 një shigjetar i tmërrshëm dhe kolos
 si orator dhe ligjërën bilbil
 edhe kur na e paska zënë rrufa!...

LIBRI I TRETË

Satira VIII

- Ç'i hyn në punë stema kujt e ka?...
Vetëm e vetëm një fisnikëri
njeriu mund t'arrijë të fitojë:
atë që e ka burimin te Virtuti.
- Qofsh ti makar nga dyer të mëdha 5
të Paulve, të Kosëve o të Drusëve,
virtutet që ti ke, dhe asgjë tjetër,
duhet të varësh me nderim përpara
kujtimit të stërgjyshërve të tu...
- Ti duhet të tregosh, para së gjithash, 10
virtutet shpirtërore, që ti ke
dhe të dëshmosh nëse të shkon përshtat
të quhesh ti fisnik që dashuron
— me vepra, jo me fjalë — drejtësinë...
- Ty po të flas këtu, o Bland Rubel!
Ty ta ka rritur mendjen ajo stemë 15
krenare e oxhakut të dëgjuar
të Drusëve, pa bërë asnjë vepër
nga ato që i bëjnë njerëzit fisnikë.

Përkundrazi, fisnikëria jote
 rrjedh ngaqë të paska lindur një femër 20
 prej gjaku të shkëlqyer fort të Julit,
 e jo një nga ato endëset e mjera,
 që për disa qindarka robëtohen
 nën çfarëdolloj strehe, dita-ditës, 25
 ku ç'bie jashtë, bie edhe brenda.
 «Harbutë jeni ju, — mund të më thuash, —
 dhe fundërrinat e vegjëlisë sonë!
 Asnjë prej jush nuk mund të më tregojë
 ku lindi i ati, kurse unë jam 30
 pasardhës i Cekropit të dëgjuar!»
 Më rrofsh! T'u bëftë dita ty njëmijë,
 që t'ja pish lëngun sa më shumë kohë
 asaj prejardhje! Veç mos harro kurrë
 se nga kjo vegjëli, prej teje përçmuar, 35
 del avokati i mprehtë që mbron gjyqet
 e çfarëdo fisniku kokëkungull;
 nga gjiri i vegjëlisë del juristi,
 që zgjidh me zotësi vështirësitë
 edhe çdo nyje ligjesh; prej saj dalin 40
 gjithë të rinjtë e Romës, kryetrimat,
 që mbrojnë gjer n'Euftrat kufitë e saj!
 Po ti, në fund të fundit, s'je gjë tjetër
 përveçse një pasardhës i Cekropit!
 Thuamë pak ti, o filiz i téukrëve: 45
 prej gjithë atyre kafshëve që s'flasin,
 cilën do mund ta quanim fisnike?

S'do mend, vetëm atë që është e fortë. Ja pse e mburrim ne kalin e shpejtë, që i le të tjerët pas dhe mbrin i pari në mes të brohoritjeve të cirkut...	50
Kur është fjala, pra, për disa kuaj, stërgjyshërit e tyre s'i nderojmë, hijes së baballarëve të tyre ne nuk u bëjmë kurrë përnderime.	55
Po s'ditën të vrapojnë, shkojnë e bien në duart e ndonjë padroni tjetër, janë të denjë vetëm për një gjë: të rrotullojnë gurin e mullirit...	
Kur të arrish te ajo krahinë e largme, që po të pret guvernator të saj, dhunës — ki mendjen! — vuri fre e masë, lakmis' së pares vuri fre e masë, për aleatët tanë ki mëshirë;	60
shikoji se si janë katandisur: n'eshtrat e tyre që po thithim ne, s'ka mbetur palcë fare më... Në krye, ahere kur banorët e krahinave i nënështruam, jeta u lulëzonte,	65
ata nuk po ankoheshin si sot, plaga e tyre s'ishte barabar me dëmin që u shkaktonte dora jonë, i kishin në shtëpi gjithë të mirat.	70
Po pak më vonë erdhi Dolabela, erdhën varrimi Verri dhe Antoni	75

dhe sollën me anije nga krahinat
gjakun e vjedhur tinës edhe koskat
që po parakalonin në triumf.

Ç'fitore kishin korrur kundër njerëzve
që rronin qetësisht te vatra e tyre? 80

Tani pak qe të kanë për n'ankand,
vetëm pak kope kuajsh, po një ditë
edhe këto një kokosh mall e plaçka
— dashi, ndonjë kullotë e vogël fare,
ndonjë ikonë e shenjtë perëndie, 85

që mund t'u kenë mbetur — do grabiten.
Këto, ç'është e vërteta, janë pronëzat
më të mëdha që kanë ata akoma...

LIBRI I KATËRT

Satira X

- ...Fuqia ndjell nakar të madh. Ca bëhen
viktimat e atij, se u zë frymën
regjistri shumë i gjatë e i lavdishëm
i vargut të nderimeve. Shtatujat
përmbysen edhe ndjekin pas litarin 5
që i heq poshtë; pastaj i vjen radha
spatës, që, me disa të rëna fort,
ja copton rrotat qerres triumfale...
Për ç'arësye u shemb fati i Kràsëve
edhe i Pompeianëve? Ç'qe shkaku 10
që e rrëzoi atë tiran, i cili
dikur i ktheu në sklevër kuiritët
me një lëvizje dore? Shkaku ishte
fuqia absolute, që e arriti
me mjete të paligjshme, dhe ambicja, 15
që i ushqyen djallëzisht hyjnitë.
Të pakët janë mbretërit që zbresin
poshtë, në mbretërinë e Plutonit,
plagët e tyre pa kulluar gjak;

të pakët dhe tiranët që po vdesin 20
 pa vuajtur! Çdo nxënës, që ka prapa
 një shërbëtor me çantëzën e librave
 edhe dëgjon mësimet e filllores,
 duke paguar taksën e një aksi,
 fillon të ëndërrojë menjëherë
 të ketë gojtarinë dhe lavdinë 25
 që patën Demosteni e Ciceroni
 dhe, sa vazhdojnë festat kuinkuate,
 i lutet fort Atenës t'ja plotësojë
 dëshirën. Po edhe njëri edhe tjetri 30
 vdiqën për shkak t'asaj gojëtarie;
 talenti i madh i shpuri që të dy
 në varr, sepse gjenive të mëdhenj
 u priten kurdoherë kokë e duar!
 Po onxhot, avoketërit shpirtvegjël, 35
 tribunat nuk i kanë larë kurrë
 në For me gjak të tyre! Ciceroni,
 sikur të kishte thënë kurdoherë
 gjëra pa kripë, si te vargu i njohur
 «O Romë, moj fatlume, që ke lerë 40
 të më kesh konsull», ai do kishte mundur
 që t'u shpëtonte thikave t'Antonit!
 Shumë më mirë do të qe sikur
 të kishte thurur vargje qesharake
 e asgjë tjetër, sesa të fitonte 45
 kaqë lavdi pas asaj Filipike
 të dytë madhështore! Më pak e keqe

s'ishte edhe vdekja që pat Demosteni,
lavdia e Athinës, që me vrull
dhe mprehtësi të fjalës prekte zemrat 50
dhe krejt një popull ai peshë e ngrinte.

Po që kur lindi ai i pati kundër
si Fat dhe Perëndi! I ati, farkëtari,
i nxirë gjithënjë nga tymi i hekurit
të skuqur, nuk pat qejf ta bën si veten. 55

Por gaboji rëndë i mjeri që s'e la
me darat, me qymyr edhe me kudhra,
të farkëtonte shpata; por e nisi
që të studjonte artin për gojtar!...

LIBRI I PESTË

Satira XIV

Janë pikërisht prindët, o Fushin,
ata që, për së gjalli, ua tregojnë
edhe pastaj ua lenë trashëgim
fëmijëve ato vese të pështira,
që mbeten si një njollë e pashlyer 5
tek shpirti i bardhë i tyre... Asnjë gjë
e turpshme për t'u thënë o për t'u parë
le të mos prekë kurrë ato mure
të shenjta ku njeriu është babë..
Nderimin më të madh duhet ta kemi 10
për ta! Po qe se ti po përgatit
një akt që të ndjell turpin, ti ndero
moshën e njomë të fëmijës sate,
që duhet të të dalë si pengesë
përpara. Do të dish për ç'arësye? 15
Në qoftë se një ditë ai do bëjë
diçka që merr dënimin nga Censori;
në qoftë se ai do të të ngjasë
në trup e në fytyrë edhe në sjellje;

në qoftë se ai, e përsëris, 20
 një ditë, sipas gjurmëve të tua,
 do bëjë vepra ca më të pështira,
 s'do mend se ti atë do ta qortosh
 edhe do ta dënosh duke bërëtitur,
 i gatshëm që të ndrrosh dhe testamentin. 25
 Po ku do ta gjesh dot ti çiltërinë
 që i duhet një babai, kurse zotrote,
 një burrë plak, je duke bërë akte
 dhe ca më të pështira, edhe kokës
 sate, prej disa kohe ngelur tytë, 30
 i nevojitet kura me venduza?
 Kur prisnin ndonjë mysafir, të gjithë
 ju, të shtëpisë, ja filloni punës:
 lustronin shtyllat, fshini dyshemenë,
 fshini një merimangë të uritur. 35
 «O burra!» thrret padroni. «Një nga ju
 le të lustrosë argjëndin e lëmuar,
 një tjetër ato vazot e skalitura!»
 Zëri i padronit, q'është i pranishëm
 kudo me një kamzhik në dorë, çirret. 40
 Ti ke merak që hyrja e shtëpisë,
 fëlliqur nga të ndoturat e qenit,
 të lerë ajo një mbresë mjaft të mirë
 në sytë e atij miku që do vijë.
 Ke frikë se mos derë e hyrjes është 45
 ndotur me baltë — e megjithatë,
 një nga shërbëtorët, me një grusht tallashi,

mjafton t'i bëjë gjithë këto punë —
 dhe nuk mendon se si t'i duket djalit
 shtëpia jote e shenjtë dhe e pastër 50
 nga njolla vesesh. Është gjë e bukur
 t'i falsh një qytetar të ri atdheut
 dhe popullit, po qe se ti e bën
 një qytetar të denjë për atdheun,
 të aftë për çdo punë bujqësore, 55
 të zotin në koh' lufte e koh' paqe.
 Lejleku i ushqen fëmijt' e tij
 të vegjël me gjarprinj e me hardhuca
 të gjetura në fushat më të largëta.
 Ata pastaj, kur nxjerrin pendët, prapë 60
 po atë gjah kërkojnë lart e poshtë...
 Por duhet të pranojmë se të rinjtë
 shumë të gatshëm janë që të ndjekin
 vullnetarisht dhe shembulla të tjera.
 Dhe vetëm kopracisë nuk i falen, 65
 po s'qenë detyruar me pahir...
 Në qoftë se një at' na është i bindur
 se çdo njeri koprac na është i lumtur,
 në qoftë se s'i falet veç parasë,
 në qoftë se e quan të pamundur 70
 të gjendet dot makar dhe një njeri
 i vetëm që të jetë edhe i varfër
 dhe i gëzuar, ahëre ky babë
 e ndjen si për detyrë që t'i nxitë
 të rinjtë për të ndjekur dhe ata 75

- rrugën e tij e t'i kushtohen ushtrimit
të kultit të atij. Ka një metodë
shkencore për të përhapur mirë veset.
Sipas kësaj, ai stërvit dishepujt
e tij e i shtrëngon që të mësojnë
çdo shfaqje t'hollësishme kopracie,
që më pastaj t'arrijë t'u mësojë
lakminë e pangopur të fitimit. 80
- Ua zvogëlon stomakun me recione
të vogëla ushqimi shërbëtorëve,
duke u dhënë vetë ai shembullën
e agjërimit. Ai s'lejon kurrë
që t'hidhen poshtë copërat e mbetura
të bukës që ish mykur; dhe, në mes
të muajit shtator akoma, ai
e ka zakon të ruajë ushqimet
e mbetura prej ditës së mëparshme
edhe të shtrojë prapë mbi tryezë
pjtën me bathë edhe një racion
prej peshkut që e ka qelbur zhegu i verës... 95
- Edhe të gjitha me lapës në dorë.
Po ç'farë vlejné gjith'ato thesare
që ti më mbledh me vajtje e mundime,
duke më bërë ti një jetë qeni
vetëm e vetëm që t'arrih të vdesësh
në fund si milioner? A s'është kjo
një marrëzi e plotë, pa dyshim? 100
- Thesaret që arrin të grumbullojë

njeriu me mundime e sëmundje të tilla, sjellin me vete kokëçarje	105
» frikë, aman o zot, kur është fjala t'i ruash se mos t'ikin, sepse ruajtja » pasuris' së madhe është burim fatkeqësish! Njeriu pasanik	
Licinas, që ka rënë mjaft nga gjendja, jep urdhër një morie shërbëtorësh ta gdhijnë pranë kovave plot ujë, se mos i bie zjarri qehlibarit, në shtylla e orendi bukur stolisur me kurriz peshku, dhëmbë elefanti.	110
Kurse ajo fuçi, ku ka banesën ciniku i leckosur, s'ka rrezik të marrë zjarr; po dhe sikur t'ja thyesh, të nesërmen do bëjë menjëherë një shtëpi tjetër po të këtij lloji, ose ka për ta ngjitur me pak plumb dhe do banojë në shtëpinë e parë.	115
Leka i Madh, kur pa se ajo fuçi e famëshme shërbente si banesë e një njeriu të madh, që gjithë e njohin, kuptoi se, duke mos dëshëruar kurrë asgjë, ai filozof ishte shumë m'i lumtur nga sa ishte ai, që donte të rrëmbente gjithë botën...	120
Fatin ne vetë e kemi fytyruar si perëndi. Pó dëshiroi ndonjëri	125
	130

këshillën time, ja, do t'i tregoj
masën e pasurisë që i mjafton:
njeriut i duhet aqë pasuri,
sa është e domosdoshme për t'u mbrojtur 135
nga etja, nga uria e nga të ftohtët;
aqë sa i mjaftoi Epikùrit
në kopështin e tij të vogël, aqë
sa kishte, përmbi çdo pasuri tjetër,
shtëpia e Sokratit n'atë kohë... 140

SHËNIME

LIBRI I PARË

Satira I

Kordi — një bejtexhi i kohës.

Teseida — një poemë që fliste për ngjarjet e Trojës.

Aurunka — vendlindja e *Luçilit*, të parit poet të shquar satirik të Romës.

Matoni — një avokat dallaveraxhi, që u pasurua me shpifje në kohën e Neronit.

Këtu Juvenali fshikullon *Marius Priskun*, i cili, pas grabitjeve të mëdha që bëri në Siqeli, u dënua të paguajë 700 mijë sesterce dhe u internua. Megjithatë, ai vazhdoi të bënte në internim një jetë luksoze dhe të degjeneruar.

Feneri i Venozës — poeti i madh lirik e satirik Horaci.

Ikari e Dedali — heronj mitologjikë. I dyti, për të ikur nga Kreta, ndërtoi krahë dylli për vete dhe për Ikarin.

Kalene — Një nga verërat e famshme të Kampanisë.

Lokusta — magjistare e famshme e kohës së Neronit. Thuhet se helmoi Klaudin dhe Britanikun. U dënua me vdekje nga Galba.

Kluviëni — bejtexhi, me të cilin, ironikisht, Juvenali krahason veten e tij.

Tigelini — oborrtar i famshëm për egërsinë e tij, i favorizuar nga Neroni. Neroni ndriçonte lulishtet e tij duke gozhduar në shtyllat në formë kryqi të krishterët e parë, të cilëve, u vinte zjarrin pasi i lyente me rrëshirë.

Juvenali do të flasë në satirat e tij për të vdekurit, sepse ata nuk mund të hakmerreshin. Boskat (urnat), me hirin e patricëve të vdekur, ndodheshin gjatë rrugëve Flaminia, Latina dhe Apia.

Satira III

Proçida — një ujdhesë e shkretë dhe e egër, që s'pëlqehet nga romakët. Nga fundi i shekullit I pas erës sonë, recitimet në Romë, ishin bërë një mani shumë e përhapur.

Artori e *Katuli* — afaristë e dallaveraxhinj të mëdhenj. Shumë veta jetonin duke shfrytëzuar kriminalitetin e fëmijëve të degjeneruar, të cilët bënin çmos t'ua shkurtonin jetën prindërve para kohe për të trashëguar pasurinë.

Britarë — që i bien bririt (si burizanët).

Rosh Otoni — tribun, që, në vitin 68 para erës sonë, kishte bërë të aprovohej një ligj, i cili urdhëronte që, ndër cirqet, qytetarët të rreshtoheshin në 14 radhë shkallësh, sipas pasurisë që zotëronin. Vendet e të pasurve i dallonte një jastëçkë.

Satira IV

Domiciani — perandori i fundmë i derës së *Flavëve*.

Pontifeksi i Epërm, — domethënë kryetari i fesë, që ishte vetë perandori.

Spiunë — «rojet e taksës», ndalonin të peshkohej kontra-bandë.

LIBRI I DYTË

Satira VII

Klioja — një nga nëntë muzat e Olimpët, që kishte në patronazh historinë.

Aganipeja — burim i muzave në një mal pranë Tespies (në Beotinë greke); kush pinte ujin e këtij burimi, bëhej poet.

Pieriane — nga mali Pier, seli tjetër e muzave në Maqedoni.

Maskera — emër kasneci publik.

Alçitoi — e bija e Mineut, u tall me ceremonitë e Dionisit dhe për këtë u transformua në zog nate.

Paci — bejtexhi i njohur. Këtu bëhet fjalë për një vepër poetike të Pacit, me titull «Alçitoi».

Faustini — tjetër bejtexhi, që jetoi rreth vitit 100 para e. s.; këtë e përmend edhe Marciali në «Epigramet» e tij. Nga sa thotë Juvenali, Faustini qe autor dy veprash poetike: njëra «Teba» dhe tjetra «Tereu». Këto poema të përbuzshme shiteshin në ankand, sepse s'i blinte askush në librari.

Telesini — poet tjetër, i përmendur edhe nga Marciali.

Vullkani — zoti i zjarrit.

Palloi — zog i shenjtë i Zeusit.

Terpsikora — muzë e vallëzimit.

Dikush kishte huajtur fronet luksoze për recitim.

Këto, natyrisht, duhej të ktheheshin.

Aonide — muzat e krahinës Aonia, ku ndodhet mali Elikon.

Cirra — qytet i Focidës, i shenjtë për Apolonin si Nisa. Andaj me shprehjen «ligjet e Cirrës e të Nisës» nënkuptohen ligjet poetike.

Furiet — hyjni, xhinde.

LIBRI I TRETË

Satira VIII

Pal Emili — udhëheqës ushtarak, që mundi maqedonasit në Pidna, 168 para e.s Kornel Kosi luftoi kundër sanitikëve, 341 para e.s. Drusi, djali i Augustit, mundi gjermanët.

Kaj Bland Rubeli — nip i Drusit nga ana e nënës Julia.

Julia — nëna e Bland Rubelit, që rridhte nga Jul Cezari.

Çekropi — themeluesi mitologjik i Athinës.

Publ Kornel Dolabela dhe Kaj Antoni, bir i Mark Antonit
— administratorë të këqij krahinash.

Vërri — kusari më i dëgjuar i administratës shtetërore.

LIBRI I KATËRT

Satira X

Familjet e *Krasit* e të *Pompeut*, që u shkatërruan nga luftrat civile të shekullit I para erës sonë.

Plutoni — perëndia e botës së nëndheshme.

Festat kuinkuate, — festa për nder të Minervës, që bëheshin prej 19 gjer më 23 mars; dhe në këto ditë nxënësit kishin pushim.

Në tribunat e Forit, domethënë në atë tarracë nga flisnin oratorët, u ekspozua koka e prerë e Ciceronit.

Ligjërata e dytë kundër Antonit, që Ciceroni e quajti Filipike.

LIBRI I PESTË

Satira XIV

Fushini — një bashkëkohës i Juvenalit.

Licini — pjesëtar i familjes së Licinëve, që ishin shumë të pasur dhe thirreshin «Divites».

Filozofët cinikë, dishepuj të Antistenit dhe të Diogjenit, përçmonin çdo kotësi të qytetërimit. Diogjeni banonte në një fuçi.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Parathënje	3
Libri i parë: Satira I	11
Satira III	16
Satira IV	21
Libri i dytë: Satira VII	24
Libri i tretë: Satira VIII	30
Libri i katërt: Satira X	34
Libri i pestë: Satira XIV	37
Shënime	43

Cmimi lekë 1.50